

V E N D I M
Nr. 621, datë 18.9.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “SISTEMIM I BLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN ‘LONI DHAMO’,
LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim i blokut të banimit në lagjen ‘Loni Dharmo’, Lushnjë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet për pasurinë e llojit “ndërtesë”, garazh, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 400 297 (katërqind mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasurinë e llojit “ndërtesë”, garazh, me vlerë 400 297 (katërqind mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, të përballohet nga fondet e Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronari, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, e të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**Lista e pronarit të pasurisë, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit
 “Sistemim i bllokut të banimit në lagjen ‘Loni Dhamo’, Lushnjë”
 Vlerësimi për objektet është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000**

Nr.	Emër, Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Sajmir Ali Kurti	ndërtesë (garazh)	8572	5/44-Nd	20	20	400,297.00	Konfirmuar nga ZVRPP Lushnjë me shkresën nr. 5064/1 prot, datë 5.7.2018
Vlera totale paraprake					20		400,297	